



# **RAPORTI VJETOR**

**SEKTORI ADMINISTRATËS,  
FINANCËS DHE BURIMEVE NJERËZORE**

**2015**

## Përmbajtja

Hyrje .....	3
1. Burimet e financimit të veprimtarisë .....	3
1.1. Pagesa rregullatore për vitin 2015.....	4
1.2. Likuidimi i pagesave rregullatore .....	5
1.3. Operatorë me detyrime të pagesave rregullatore.....	6
2. Shpenzime operative.....	7
2.1. Plani i shpenzimeve operative .....	7
2.2. Shpenzimet operative .....	8
3. Burimet njerëzore .....	9
3.1. Gjendja aktuale e plotësimit të organikes së ERRU .....	10
3.2. Trajnime dhe kualifikime .....	11
3.3. Trajtimi e motivimi i nëpunësve e punonjësve.....	11

### Aneksë

- 1.1 Evidence analitike e gjendjes së pagesave rregullatore të operatorëve
- 1.2 Evidence analitike vjetore realizimit të shpenzimeve

## Hyrje

Në punën e tij gjatë vitit 2015, Sektori AFBNJ ka siguruar e garantuar mbështetjen logjistike për organizimin e zhvillimin me sukses të gjithë veprimtarive si dhe funksionimin normal të aktivitetit të përditshëm të ERRU.

Ky vit është karakterizuar për vijimësi të pandërprerë të një sërë aktiviteteve të veprimtarish në terren me operatorët, këto të lidhura ngushtë edhe me reformën administrative në vend si dhe me kujdesin për realizimin e objektivave vjetore të institucionit, që lidhen me rregullimin në sektorin UK. Këto aktivitete të veprimtarish janë zhvilluar si në drejtim të hartimit e propagandimit të ndryshimeve të rregulloreve e metodikave për ti bërë ato bashkëkohore ashtu edhe në drejtim të forcimit të rolit të rregullatorit e të marrëdhënieve me operatorët, pushtetet vendore e konsumatorët.

Gjithashtu garantimi i të ardhurave, për financimin e aktivitetit vjetor të ERRU, nëpërmjet arkëtimit të pagesave rregullore nga operatorët dhe përdorimi i tyre me efikasitet e në përputhje të plotë me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, ka qenë në qendër të vëmendjes së punës tonë, pavarësisht rezultatit i cili do të analizohet me poshtë.

Në analizën vjetore të punës në sektor, do të ndalemi në pasqyrimin dhe analizën e të gjithë treguesve ekonomik-financiar të vitit, duke trajtuar më gjerë këto çështje:

- 1- *Burimet e financimit të veprimtarisë së Entit*
- 2- *Shpenzimet operative*
- 3- *Burimet njerëzore*

### 1. Burimet e financimit të veprimtarisë

Sikurse përcaktohet në ligjin nr.8102, datë 28.03.1996, pagesat rregullore dhe pagesat nga licencimet janë burimet e financimit të aktivitetit të veprimtarisë së ERRU.

Për vitin 2015, të ardhurat totale të realizuara nga burimet e financimit, janë në shumën 39 652 mijë lekë kundrejt 50 127 mijë lekë të realizuara në vitin 2014. Të analizuar sipas burimeve të financimit të ardhurat e vitit 2015, ndahen në:

- 39 312 000 lekë nga pagesat rregullatore,
- 340 000 lekë nga pagesat për licencime.

Gjatë këtij viti projekti gjerman nëpërmjet GIZ ka vazhduar të financojë disa aktivitete dhe veprimtari të Entit. Konkretisht janë financuar aktivitete të Entit për trajnime të ndryshme të operatoreve, aktivitete në kuadrin e bashkëpunimit e shkëmbimit të eksperiencave me institucione të huaja e ndërkombëtare, botimi i Raportit të performancës për vitin 2014, etj.

Të ardhurat e realizuara për vitin 2015 garantuan tërësisht mbështetjen financiare dhe mbulimin e shpenzimeve vjetore të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit të Entit. Niveli i arkëtimit të pagesave rregullatore për vitin është 10 milion lekë më i ulët krahasuar me arkëtimet e vitit të mëparshëm.

Është evident fakti se në vitet e fundit të ardhurat e realizuara kanë mbuluar shpenzimet buxhetore të rregullatorit, por nuk janë realizuar në përputhje me kontratat. Më poshtë do të analizojmë në mënyrë më të hollësishme situatën mbi pagesat rregullatore

### 1.1. Pagesa rregullatore për vitin 2015

Detyrimi vjetor i konstatuar për pagesat rregullatore për vitin 2015, mbështetur në kontratat përkatëse, është në shumën 45 395 mijë lekë. Kjo vlerë përfaqëson detyrimin e pagesave rregullatore për 43 operatorë, të cilët punojnë me tarifë të miratuar nga Enti, dhe kanë kontratë për pagesën rregullatore.

Nuk përfshihen në skemën e operatorëve që kanë pagesë rregullatore 13 operatorë, mbasi nuk kanë tarifë të miratuar nga Enti. Konkretisht këta operatorë janë: Sha Uk Ballsh, Sha u F. Arrëz, Sha u Has, Sha U Këlcyrë, Sha U Libohove, Sha U Divjake, Sha U Malësi e Madhe, Sha UK Patos, Sha U Puke fshat, Sha U Himarë dhe Sha u Vau i Dejës.

Në total detyrimi i gjithë operatorëve për vitin 2015, ishte në shumën 130 445 mijë lekë, prej të cilave 85 049 mijë lekë janë detyrimeve të pashlyera përpara vitit 2015 dhe 45 395 mijë lekë janë detyrime të vitit.

Detyrimi vjetor i konstatuar i operatorëve për pagesat rregullatore për vitin 2015 është pothuajse i barabartë me atë të vitit të mëparshëm, vit në të cilin KKRR uli në masën 30 % pagesat rregullatore te operatoreve.

Ne tabelën e mëposhtme paraqitet ecuria e pagesave rregullatore vjetore të kontraktuara me operatorët në vitet 6 vitet e fundit.

Viti	Pagesa rregullatore vjetore
2010	36,068
2011	40,829
2012	62,236
2013	61,916
2014	45,507
2015	45,395

Me një vështrim të përgjithshëm mbi këtë tabelë vërejmë një rritje të konsiderueshme të pagesës rregullatore në dy vitet 2012 dhe 2013. Krahas gjithë faktorëve të tjerë edhe kjo rritje ka influencën e saj në rritjen e detyrimeve të pashlyera të pagesave rregullatore.

## 1.2. Likuidimi i pagesave rregullatore

Rregullatori edhe gjatë këtij viti, problemit të likuidimit të pagesave rregullatore i ka kushtuar një vëmendje të veçantë. KKRR, në vazhdimësi ka kërkuar dhe është informuar për këto probleme me të dhëna e informacione të ndryshme për marrjen e masave për përmirësimin e gjendjes.

Pavarësisht gjithshkaje që është bërë gjatë vitit likuidimi pagesave rregullatore rezulton të jetë në nivel jo të kënaqshëm. Janë likuiduar vetëm 39 319 mijë lekë, vlerë kjo 10 milion lekë më e vogël se arkëtimet e një viti më parë.

Në se analizojmë sipas viteve totalin vjetor të likuidimit të pagesave rregullatore në këtë vit, konstatojmë se për llogari të vitit 2015 janë likuiduar 12 461 mijë lekë, ndërsa për llogari të viteve të mëparshme 26 853 mijë lekë.

Në fund të vitit, pagesat rregullatore të pashlyera janë në shumën 91 131 mijë lekë.

Likuidimi pagesave rregullatore në vitet e fundit.

Viti	Shuma e likuiduar
2010	40 891
2011	31 077
2012	37 865
2013	20 405
2014	50 127
2015	39 319

Është lehtësisht e dallueshme se likuidimi i pagesave rregullatore ne vitin 2015 ka rënie të konsiderueshme krahasuar me 2014.

Ndër operatorët që kanë shlyer detyrimet rregullisht përmendim shoqëritë Bilisht, Bulqizë, Elbasan fshat dhe qytet, Gjirokastër qytet, Korçë qytet dhe fshat, Krastë, Lezhë, Mirditë, Rubik, Sarandë, Shkodër qytet dhe Vlorë.

Në kushtet kur nuk likuidohen rregullisht pagesat rregullatore Enti është i detyruar të përdorë të ardhurat e krijuara nga vitet e mëparshme për të përballuar shpenzimet vjetore, kur në bazë të akteve ligjore e nënligjore në fuqi këto të ardhura duhet të derdhen në buxhet çdo vit.

Aktualisht i detyrohemi buxhetit të shtetit në fund të vitit 2015 në shumën 91 131 mijë lekë. Në muajin janar 2016, nisur nga gjendja e mjeteve monetare të disponueshme në llogarinë tonë bankare dhe fondi vjetor i miratuar nga qeveria për vitin 2016 do të derdhim tepërisht në buxhetin e shtetit në shumën 8 963 231 lekë.

### 1.3. Operatorë me detyrime të pagesave rregullatore

Me detyrimet më të larta të pashlyera paraqiten operatorët Sha UK Berat-Kuçovë me 1 089 530 lekë, Sha UK Durrës me 12 377 900 lekë, Sha UK Kavajë me 5 132 600 lekë , Sha Uk Krujë me 1 367 000 leke, Sha U Kurbin me 2 000 000 leke, Sha Uk Tiranë me 48 540 000 lekë, Sha U Shkodër fshat 1 380 400 leke, Sha UK Tepelene me 1 075 500 lekë, Sha UK Fier me 8 826 670 lekë. Në total detyrimi i këtyre operatorëve është në shumën 81 749 600 lekë. Kjo shifër krahasuar me detyrimin e pashlyer në total përbën 89.7 % te tij.

Në të gjitha kontratat që Enti ka lidhur me operatorët për aplikimin e tarifave, ka vendosur pagesën rregullatore vjetore dhe afatet e likuidimit të saj në tre këste gjatë një viti, gjithashtu kontrata ka parashikuar se mosmarrëveshjet midis palëve do të zgjidhen në gjykatë.

Deri më sot, Enti vazhdimisht ju ka bërë me dije operatorëve detyrimet e tyre në lidhje me pagesat rregullatore, si ato ligjore ashtu dhe vlerat përkatëse, duke tërhequr herë pas here vëmendjen e tyre në këtë drejtim. Gjithashtu gjatë këtij viti zhvilluar dy procese gjyqësore për likuidimin e pagesës rregullatore për Fierin dhe Kavajën. Praktikisht te dy këta operatore ende nuk kane likuiduar asnjë pagese.

Pagesa për licencim është gjithashtu burim të ardhurash për rregullatorin. Për vitin 2013 janë arkëtuar nga operatorët e licencuar 340 000 lekë ose 0.08 % te totalit të të ardhurave.

## 2. Shpenzime operative


Plani vjetor i shpenzimeve operative të Entit propozohet nga ai vetë dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave. Enti në hartimin e planit vjetor të shpenzimeve, kushtëzohet edhe nga mundësitë e tij për realizimin e të ardhurave, që vështirësohet në kushtet e gjendjes ekonomike financiare të një pjese të mirë të shoqërive UK.

Përmbushja e detyrimeve ligjore të Entit në kuadër të reformës administrative, realizimi i objektivave vjetore për rregullimin e vazhdueshëm të sektorit UK, kushtëzojnë zgjerimin e aktivitetit dhe veprimtarisë së Entit dhe kërkojnë mbështetje financiare duke reflektuar rritje në shpenzimet vjetore të institucionit.

### 2.1. Plani i shpenzimeve operative

Për vitin 2015, plani vjetor i shpenzimeve operative te ERRU, është miratuar me VKM nr. 99, datë 04.02.2015 “Për miratimin e planit të shpenzimeve, për vitin 2015, të Entit rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”.

Plani vjetor i shpenzimeve operative të Entit për vitin 2015 është në shumën 39.043 500 lekë dhe i detajuar në janar është detajuar me urdhër të titullarit. Paraqitet në zërat si më poshtë:



Paga dhe shpërblime	23,166,500 leke
Sigurime shoqërore	3,350,000 leke
Shërbime e furnitorë	11,290,000 leke
Investime	1,237,000 leke

Në fillim të vitit zërat shërbime e furniturë dhe investime me urdhër të Kryetarit janë detajuar në nenëra shpenzimesh në përputhje me nevojat e institucionit. Gjatë vitit detajimi i buxhetit është rishikuar 2 herë pas mbylljes së katërmujorit të parë dhe të dytë, respektivisht në maj dhe shtator, me qëllim përbalimin e shpenzimeve të parashikuara.

## 2.2. Shpenzimet operative

Gjatë vitit 2015, shpenzimet buxhetore të kryera për ushtrimin e aktivitetit e veprimtarisë vjetore të Entit janë në shumën 35 780 000 lekë, ose 92 % të fondit të planifikuar.

Sektori AFBNJ, në mbyllje të çdo katërmujori, ka informuar KKRR mbi monitorimin e shpenzimeve buxhetore të kryera si dhe mbi realizimin e të ardhurave.


Të detajuara sipas zërave shpenzimet e kryera paraqiten si më poshtë:

- 21,941,000 lekë, shpenzime për pagat e punonjësve.
- 3,368,000 lekë, shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore.
- 10,395,000 lekë, shpenzime për shërbime e furniturë.
- 85,000 lekë, shpenzime për investime.

Përdorimi i fondeve të planifikuara, është bërë në zbatim të akteve ligjore e nënligjore në fuqi si për trajtimin me paga e shpërblime të të punësuarve ashtu dhe për blerjet e mallrave e shërbimeve të ndryshme në përputhje e në zbatim të plotë me ligjin “Për prokurimet publike”. Po kështu është ndjekur në vazhdimësi edhe përmbushja e detyrimeve kontraktuale për mallrat dhe shërbimet e ndryshme duke kryer njëkohësisht edhe pagesat përkatëse.

Krahasuar me planin e miratuar nga KM, shpenzimet paraqiten në grafikun e mëposhtëm:





Fondi i pagave e shpërblimeve është realizuar në masën 94.7 përqind të fondit të planifikuar. Fondi i planifikuar në zërin sigurime shoqërore është realizuar në masën 100 përqind. Fondi i planifikuar në zërin “Shërbime e furniturë” është realizuar në masën 92 përqind. Me këto fonde, në përputhje me detajimin, gjatë vitit janë siguruar kushtet e mjetet optimale të punës si dhe një bazë materiale logjistike e domosdoshme për përmbushjen e detyrave funksionale të Komisionit dhe gjithë stafit punonjës.

Fondet e planifikuara në zërin investime janë shpenzuar në nivel shumë të ulët, mbasi në kushtet kur në muajin janar të vitit 2015, u vendos që Enti të zhvendosej nga ambientet ekzistuese të punës nuk mund të kryhej rikonstruksioni i parashikuar.

### 3. Burimet njerëzore

Në zbatim të Vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr. 94, date 05.05.2008 të Kuvendit të Shqipërisë për miratimin e strukturës dhe organikes është zbatuar me përpikëri Ligji Nr. 9584 date 11.07.2006, ”Për pagat shpërblimet dhe strukturat e institucioneve kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”, si dhe Vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve dhe punonjësve të institucionit.

Në lidhje me pagesat për kualifikimet master të nëpunësve është konstatuar se janë kryer pagesa në papajtueshmëri me Vendimin përkatës dhe janë duke u ndjekur procedurat për njoftimin dhe çdëmtimin e vlerave të përfituara nga 3 nëpunës.

Ne vitin 2015 përse i takon burimeve njerëzore janë ndjekur e zbatuar me përpikëri detyrimet e Ligjit nr. 9367 date 07.04.2005” Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe te Ligjit nr. 9049, date 10.04.2003” Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik”.

Nga ana e zyrtareve që janë subjekt i detyrimit te deklarimit janë plotësuar dhe dorëzuar ne kohe pranë ILKDP deklaratat periodike te interesave private për vitin 2014.

Në muajin mars u krye inspektimi nga inspektorët e ILDKPKI, nga ana e të cilëve u konstatua se janë përmbushur me korrektësi detyrimet e autoritetit përgjegjës si dhe të zyrtareve që mbartin detyrim për deklarim periodik.

Komisioni Kombëtar Rregullator, ne ushtrim te kompetencave e funksioneve të tij, bazuar në ligjin nr. 8102, date 28.03.1996, në fillim të vitit zhvilloi procedurat përkatëse për plotësimin e funksionit të specialistit në sektorin ekonomik dhe te monitorimit, gjë që u realizuar në muajin shkurt të këtij viti.

Në tre muajt e fundit një nëpunës është larguar për arsye familjare me mirëkuptimin e KKRR. Numri gjithsej i nëpunësve dhe punonjësve të ERRU është 20 vete kundrejt 21 që përcakton organika e ERRU ose 95.2 % të saj.

### 3.1. Gjendja aktuale e plotësimit te organikes se ERRU

Emërtimi sipas kategorive	Organika	Plotesuar
<b>Gjithsej</b>	<b>21</b>	20
<b>Anëtareve te Komisionit</b>	<b>5</b>	5
<b>Nëpunës</b>	<b>13</b>	12
Punonjës mbështetës	<b>3</b>	<b>3</b>

Aktualisht ne organiken e Entit kemi 1 vend te paplotësuar, në pozicionin e specialist në sektorin tekniko & IT.

### 3.2. Trajnime dhe kualifikime

Zhvillimi i një sere aktivitetesh te programuara për kualifikimin profesional te punonjësve, trajnime e shkëmbime eksperiencash me institucionet homologe te vendeve te ndryshme është mbështetur financiarisht nga fondet e vetë Entit, por edhe nga projekti GIZ që financohet nga qeveria gjermane. Ndër aktivitetet kryesore gjatë vitit 2015 mund të përmenden pjesëmarrja e anëtarëve të Komisionit Kombëtar Rregullator si dhe nëpunësve të institucionit në disa evente si:

- Konferenca ndërkombëtare të IWA
- Takimet periodike te WAREG
- Workshop i ERRA
- Takimet e OECD
- Konferenca vjetore SHUKALB & SHUKOS

Enti ne bashkëpunim dhe me donatore te huaj, ka organizuar edhe disa Workshope, me nëpunësit e ERRU dhe drejtuesit e stafet menaxheriale te operatoreve ne sektorin UK, me tema te ndryshme mbi metodologjinë e përlllogaritjes së kostove të impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura, vlerësimin e investimeve ne sektor etj.

### 3.3. Trajtimi e motivimi i nëpunësve e punonjësve.

Marrëdhëniet e punës ne ERRU janë ndërtuar ne përputhje e ne zbatim te plote me Kodin e Punës, si dhe te akteve te tjera ligjore e nënligjore ne fuqi. Ne përcaktimin e kohës se punës dhe pushimit për punonjësit, Enti ndjek e zbaton kërkesat e akteve ligjore e nënligjore ne fuqi qe rregullojnë marrëdhëniet e kohës se punës e pushimit, e aktualisht punohet me 40 ore ne jave. Kohëzgjatja e pushimeve vjetore është jo me shume se 28 dite kalendarike dhe kryhet gjate vitit deri ne tremujorin e pare te vitit pasardhës. Ne çdo rast ditët e pushimit vjetor kryhen me urdhër te Kryetarit.

Në lidhje me paaftësinë e përkohshme në punë, mund të themi se ajo është thuajse e papërfillshme si për nëpunësit ashtu edhe për punonjësit të cilët gëzojnë shëndet të plotë. Gjithashtu edhe prezenca në punë e punonjësve ka qenë e mirë dhe është evidentuar rregullisht në fund të çdo muaji duke ju paraqitur financës për përlllogaritjet e pagave mujore të punonjësve.

Edhe këtë vit u mundësua pagesa në natyrë e punonjësve të Entit në përputhje me katet ligjore nënligjore ne fuqi si dhe me kontratat e punës. Në fund të vitit, mbështetur në aktet ligjore e nënligjore ne fuqi për shpërblimet e punonjësve, me fondet ne dispozicion, te gjithë personat e punësuar dhe nëpunësit u shpërblyen.